



Kryetari i Komunës
Nr. 01/____
Datë; 14/03/2019

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 18-03-2019.
PRILLEN: _____
Nr.No.Br. 01-324

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 14.03. 2019 mori këtë;

AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 50,000.00 €.

I I. Mjetet lejohen në emër furnizimit me 52 sera me sipërfaqe prej 100 m² për nevojat e fermerëve të Komunës së Malishevës. Mjetet lejohen sipas kërkesës së drejtorisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet dhe drejtoria bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, përmes shërbimit të prokurimit publik.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet,
2. Drejtorisë për bujqësi,pylltari dhe zhvillim rural,
3. Shërbimit të prokurimit,
4. Arkivit të komunës.



Kryetari i Komunës
Ragip Begaj



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 12/03/2019

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja f dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, dhe kërkesës së drejtorisë për urbanizëm për zëvendësimin e menaxherit të kontratës-organit mbikëqyrës.

Kryetari i Komunës me datë 12.03.2019 mori këtë;

AKTVENDIM
PËR NDËRRIMIN E MBIKQYRSIT TË KONTRATËS

I. Lejohet zëvendësimi i mbikëqyrësit të projektit "Ndërtimi i rrugëve në fshatrat e Komunës së Malishevës ", sipas kërkesës së parashtruar nga drejtoria për urbanizëm, në kuadër të KK-Malishevës.

I I. Bazuar në kontratën nr.71, sipas protokollit nr.03/110, dt.26.09.2018, sipas prokurimit nr.62500-18-5878-521, organ mbikëqyrës në realizimin e kontratës në lidhje me projektin e lartpërmendur, ishte caktuar z.Xhafer Binishi, zyrtar në drejtorinë për urbanizëm. Meqenëse ky projekt ende nuk ka hyrë në procedurën përfundimtare të realizimit, si dhe duke pasur parasysh se zyrtari i lartcekur ka dal në pension, në kuadër të administratës së KK-Malishevës, në pamundësi që të ushtrojë autorizimet sipas kontratës për mbikëqyrjen e projektit në fjalë, ky organ ka parë të arsyeshme që të bëjë zëvendësimin e të njëjtit me z.Januz Krasniqi, zyrtar i urbanizmit.

I I I. Ky zëvendësim, është lejuar sipas kërkesës së drejtorit të drejtorisë për urbanizëm të datës 12.03.2019. Organi mbikëqyrës me zyrtarin e ri, duhet që të përmbushë të gjitha kërkesat e ligjit, në mënyrë që ky projekt të realizohet konform rregullave të parapara teknike dhe ligjore.

I V. Të gjitha dokumentet në bazë të cilave janë kryer procedurat e parapara me ligj (urbanizmit, drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet, shërbimit të prokurimit publik) si dhe raporti përfundimtar i pranimit teknik, sipas organit mbikëqyrës të ri që është cekur më lartë, duhet të ju nënshtrohen procedurave ligjore, ndërsa çdo devijim do të konsiderohet si shkelje e ligjit, dhe i nënshtrohet sanksioneve sipas ligjit.

V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Komisionit
2. Arkivit të komunës



Kryetari i Komunës
Ragip Begaj



Zyra e Kryetarit
Nr. 01/____
Datë; 14/03/2019

PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 18-03-2019.
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 01-321.

Mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, Rregullores së Ministrisë së Financave nr.04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni neni 8,

Kryetari i Komunës së Malishevës, me datë 14.03.2019, mori këtë :

AKTVENDIM

I. Ndryshohet komisioni vlerësues për vlerësimin e aplikimeve sipas thirrjes publike, për ofrimin e mbështetjes financiare me mjete buxhetore të KK-së, në Malishevë, për Organizatat Jo-Qeveritare të cila operojnë në Komunën e Malishevës.

I I. Komisioni i formuar sipas nenit 1 të këtij aktvendimi përbëhet me emrat e cekur si më poshtë;

- 1). Naser Morina – kryetar i Komisionit.
- 2). Esma Ulluri-anëtar i komisionit.
- 3). Besart Berisha-anëtare e komisionit.
- 4). Emrush Elshani- përfaqësues i OJQ-së, Qendra Rinore -Malishevë-ekspert i jashtëm, anëtar i komisionit.
- 5). Defrim Krasniqi- ekspert i jashtëm, anëtar i Komisionit.

I I I. Ky komision do të kujdeset për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve, të cilat kanë aplikuar sipas thirrjes publike të drejtorisë për kulturë, rini dhe sport, ndërsa i njëjti do të ushtrojë të drejtat dhe përgjegjësit, konform Rregullores së Ministrisë së Financave nr.04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, në Republikën e Kosovës.

IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Komisionit,
2. Arkivit të komunës.





Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 11/03/2019

PRANUAR

ACCEPTED ON

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

12-03-2019

01/291

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 11.03. 2019 mori këtë;

AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 790.00 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të mbulimit të shpenzimeve për pije për zyrën e kryetarit, për periudhën korrik 2018-Mars 2019. Shpenzimet janë bërë për muajt e cekur, me rastin e vizitave zyrtare që i janë bërë kryetarit të Komunës.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.



Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet,
2. Arkivit të komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 05/03/2019

PRILUPUR

ACCEPTUAR

PRILUPUR

Nr.No.Br.

12-03-2019

07/292

Mbështetur në nenin 13,24 dhe neni 58 (shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës

Kryetari i Komunës me datë 05.03. 2019 mori këtë;

AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 28,370.10 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të furnizimit me material sanitar , për nevojat e QKMF-së, “Shpëtim Robaj “ në Malishevë për vitin 2019. Mjetet lejohen sipas kërkesës së drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet dhe drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, përmes shërbimit të prokurimit publik.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dërgohet:

1. Organeve kompetente të lartcekura,
2. Arkivit të komunës.



Kryetari i Komunës

Ragip Begaj



Kryetari i Komunës
Nr. 01/____
Datë; 11/03/2019

PRANUAR
ACCEPTED ON 12.03.2019
PRIMJENI:
Nr.No.Br. 01/293

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 11.03. 2019 mori këtë;

A K T V E N D I M

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 897.33 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të servisimit të automjetit Tuareg 07Z-01-30, i cili është në shërbim të zyrës së kryetarit të komunës. Mjetet lejohen sipas kërkesës së drejtorisë për administratë, në të cilën janë të specifikuar të gjitha pajisjet të cilat duhet të rregullohen.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet dhe drejtoria për administratë të përgjithshme, përmes shërbimit të prokurimit publik.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për ekonomi,financa dhe buxhet,
2. Arkivit të komunës.

Kryetari i Komunës
Ragip Begaj



Kryetari i Komunës

Nr. 01/____

Datë; 11/03/2019

PRANITJE: 12-03-2019
ACCEPTED: 12-03-2019
PRINILLO: 07/294
Nr.No.Br. 07/294

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja f dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, dhe kërkesës së drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale,

Kryetari i Komunës me datë 11 .03. 2019 mori këtë;

AKTVENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

I. Formohet komisioni për pranimin e pajisjeve mjekësore, për nevojat e QKMF-së, " Shpëtim Robaj" në Malishevë, sipas kërkesës nr.07/36, dt.08.03.2019.

I I. Komisioni formohet në përbërje prej tre (3) anëtarësh me emrat e poshtëshënuar;

- 1. Dr.Sadri Badallaj -Kryetar i komisionit,
- 2. Dr.Mursel Gashi-anëtar,
- 3. Aben Paqarizi-anëtar.

I I I. Ky komision është i obliguar të përgatit raport me shkrim nga dita e hyrjes në fuqi të këtij akti, në lidhje me verifikimin e të gjitha furnizimeve.

I V. Të gjitha dokumentet në bazë të cilave janë kryer procedurat e parapara me ligj si dhe akti i furnizimit duhet të ju nënshetrohen procedurave ligjore, ndërsa çdo devijim do të konsiderohet si shkelje e ligjit.

V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Komisionit
2. Arkivit të komunës



Kryetari i Komunës
Ragip Begaj



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 11/03/2019

PRANOR

ACCEPTED ON

PRIMLJENO:

Nr.Np.Br.

12-03-2019

01/295

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 11.03. 2019 mori këtë;

AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 500.00 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të mbulimit të shpenzimeve për ushqim dhe pije me rastin e kremtimit të Epopesë së UÇK-së. Mjet et lejohen sipas kërkesë së parashtruar nga drejtoria për kulturë,rini dhe sport, nr.12/91, dt.11.03.2019.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet dhe drejtoria për kulturë,rini dhe sport.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për ekonomi,financa dhe buxhet,
2. Arkivit të komunës.

Kryetari i Komunës
Ragip Begaj



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës

Nr. 01/____

Datë: 11/03/2019

PRANUAR

ACCEPTED ON:

PRIMJENJO:

Nr.No.Br.

13-03-2019.

01-302

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 11.03. 2019 mori këtë;

AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 935.00 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të mbulimit të shpenzimeve për pije për zyrën e nënkryetarit, për periudhën Janar 2018- Mars 2019. Shpenzimet janë bërë për muajt e cekur, me rastin e vizitave zyrtare që i janë bërë kryetarit të Komunës.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet,
2. Arkivit të komunës.



Kryetari i Komunës
Ragip Begaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës

Nr. 01/246,

Datë; 05/03/2019

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 05.03. 2019 mori këtë;

AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 202.50 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të mbulimit e shpenzimeve për ushqim dhe pije me rastin e shtruarjes së drekës për kontribuesit e furnizimit me libra për bibliotekat e institucioneve arsimore të komunës së Malishevës. Mjetet ndahen sipas kërkesës së parashtruar nga drejtoria për arsim dhe edukim nr.11/218, dt.05.03.2019.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet dhe drejtoria për arsim dhe edukim.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.



Kryetari i Komunës
Ragip Begaj

Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për ekonomi,financa dhe buxhet,
2. Drejtorisë për arsim dhe edukim,
3. Arkivit të komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E MALISHEVËS
MUNICIPALITY OF MALISHEVE



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë: 11/03/2019

PRANUAR:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

13-03-2019.

01-303

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja f dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, dhe kërkesës së drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale,

Kryetari i Komunës me datë 11.03.2019 mori këtë;

AKTVENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

I. Formohet komisioni për pranimin e pajisjeve mjekësore, për nevojat e QKMF-së, "Shpëtim Robaj" në Malishevë, sipas kërkesës nr.07/35, dt.08.03.2019.

I I. Komisioni formohet në përbërje prej tre (3) anëtarësh me emrat e poshtëshënuar;

- 1. Hysen Mazreku -Kryetar i komisionit,
- 2. Avdyl Krasniqi-anëtar,
- 3. Valbona Gashi -anëtar.

I I I. Ky komision është i obliguar të përgatit raport me shkrim nga dita e hyrjes në fuqi të këtij akti, në lidhje me verifikimin e të gjitha furnizimeve.

I V. Të gjitha dokumentet në bazë të cilave janë kryer procedurat e parapara me ligj si dhe akti i furnizimit duhet të ju nënshtrohen procedurave ligjore, ndërsa çdo devijim do të konsiderohet si shkelje e ligjit.

V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Komisionit
2. Arkivit të komunës





Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 12/03/2019

PRANUAR

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja f dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, dhe kërkesës së drejtorisë për urbanizëm për formimin e komisionit për pranimin teknik,

Kryetari i Komunës me datë 12 .03. 2019 mori këtë;

**AKTVENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**

I. Formohet komisioni për verifikimin e punimeve (pranimit teknik) të projektit;
“ Furnizimi dhe riparimi i ngrohjeve qendrore nëpër shkollat fillore dhe të mesme “ të Komunës së Malishevës, sipas kontratës nr.102 numër të protokollit 03/155, të datës 04.12.2018 dhe numër identifikues të prokurimit nr.62500.18.217.121.

I I. Komisioni formohet në përbërje prej tre (3) anëtarësh me emrat e poshtëshënuar;

- 1. Valdete Morina -Kryetare e komisionit,
- 2. Besnik Krasniqi-anëtare
- 3. Mehdi Krasniqi- anëtar.

I I I. Ky komision është i obliguar të përgatit raport me shkrim nga dita e hyrjes në fuqi të këtij akti, në lidhje me verifikimin e të gjitha punimeve me rastin e implementimit të projektit të lartcekur.

I V. Të gjitha dokumentet në bazë të cilave janë kryer procedurat e parapara me ligj (urbanizmit,drejtorisë për ekonomi,financa dhe buxhet, drejtorisë për administratë të përgjithshme përmes shërbimit të prokurimit publik) si dhe akti i pranimit teknik duhet të ju nënshtrohen procedurave ligjore, ndërsa çdo devijim do të konsiderohet si shkelje e ligjit, dhe i nënshtrohet sanksioneve sipas ligjit.


V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Komisionit
2. Arkivit të komunës



Kryetari i Komunës
Ragip Begaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

PRANUAR SE: 15/03/2019
ACCEPTED ON:
PRILJENO:
Nr.No.Br. 01/319

Zyra e Përsoneelit
Nr.01/_____
Datë: 14/03/2019.

Mbështetje të dispozitave të nenit 18,pika 7, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 7,të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,Kryetari i Komunës me 14/03/2019, bie këtë:

V E N D I M

Për emërimin e komisionit për procedimin e përzgjedhjes së ngushtë dhe përfundimtare sipas Konkursit të shpallur nga Zyra e Personelit me 22/02/2019, nr: 01/212, për pozitën:

I. DREJTORIA PËR INSPEKTORIAT

- Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit

Komision do të punoj me këtë përbërje

1. Ali Rrahmanaj- Kryesues - **1016523590**
2. Sahit Kafexholli- Anëtarë- **1170351785**
3. Smajl Zogaj-Anëtarë - **1005671422**
4. Qendrim Gashi-Anëtarë - **1174638477**
5. Demush Krasniqi-Anëtarë- **2002802697**

Komision ka për detyrë të bëjë procedimin e përzgjedhjes së ngushtë dhe përfundimtare të kandidatëve për pozitë të lartshënuara duke respektuar Parimet e Shërbimit Civil të Kosovës.

Raporti përfundimtar duhet t'i dorëzohet në Zyren e Përsoneelit-së duke ja bashkangjitur:

a)Formularët pyetësor të plotësuar për secilin kandidatë,b)Tabelën përmbledhëse të rezultatit të intervistimit dhe dokumentacionin tjetër valid për këtë procedurë.

Nga se u theksua me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

Ky vendimi është i plotëfuqishëm që nga data e nënshkrimit.

T'I DORËZOHET:

1. Anëtarëve të komisionit.
2. Arkivit.
3. Dosjes së Rekrutimit

Kryetari i Komunës
Ragip Begaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kryetari i Komunës

Nr. 01/318

Datë: 13/03/2019

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Ligjit për Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/L-241, dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 13 .03. 2019 mori këtë;

AKTVENDIM

PËR INICIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK

I. Inicohet, procedura e prokurimit publik, për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit në lidhje me përzgjedhjen e operatorit ekonomik, për realizimin e projektit “Rregullimi i kanalizimit në fshatin Carrallukë“ KK-Malishevës. Mjetet lejohen sipas paramasës dhe parallogarisë se përgatitur nga shërbimet profesionale te drejtorisë për urbanizëm.

I I. Për qëllimin e cekur, lejohen mjetet financiare prej 998.00 €.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi autorizohet drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet dhe drejtoria për urbanizëm, drejtoria për administratë të përgjithshme, përmes shërbimit të prokurimit publik.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.



Kryetari i Komunës
Ragip Begaj

Aktvendimi ju dorëzohet:

- 1.Organeve kompetente
- 2.Arkivit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë: 08/02/2019

PRANUAR

ACCEPTED ON

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

11-03-2019

01-263

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja f dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.13/2017, Dt.06. Shtator 2017, neni 27, si dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, bazuar në kërkesën e zyrës komunale për komunitete dhe kthim, ri-integrim,

Kryetari i Komunës me datë 08 .02. 2019 mori këtë;

AKTVENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR KTHIM

I. Formohet, Komisioni Komunal për kthim, në Komunën e Malishevës, me emrat e shënuar si më poshtë;

- Edonë Krasniqi- Zyrtare për komunitete,kthim dhe ri-integrim-kryetare e komisionit,
- Besart Berisha- përfaqësues i drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale-anëtar,
- Kushtrim Krasniqi-përfaqësues i drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe shërbim pronësoro-juridik- anëtar,
- Mefail Paçarizi- përfaqësues i drejtorisë për urbanizëm-anëtar,
- Demush Krasniqi-përfaqësues i drejtorisë për shërbime publike-anëtarë,
- Remzi Buçaj- përfaqësues i drejtorisë për arsim dhe edukim,
- Lavdim Kelmendi-përfaqësues i qendrës për punë sociale,
- Përfaqësuesi i Ministrisë për Kthim dhe Komunitete-anëtar/e.

I I. Ky komision është themeluar në pajtim me kërkesën nr.01/181, dt.19.02.2019, parashtruar nga zyra për komunitete, kthim dhe ri-integrim, në kuadër të Komunës së Malishevës, ndërsa i njëjti është obliguar që të kryejë punët dhe detyrat, konform Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.13/2017, si dhe akteve tjera ligjore e nënligjore që e rregullojnë këtë çështje.

I I I. Ky aktvendim shfuqizon aktin nr.01/242, dt.05.02.2019, ndërsa i njëjti hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komunës
Ragip Begaj

Aktvendimi ju dorëzohet:

- Komisionit
- Arkivit të komunës.